



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 06/07/2021.
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 04/572



Republika e Kosovës

Komuna Malishevës

PROCESVERBAL

RENDI I DITES

Diskutim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024

Mbledhja u mbajtë me datë: 25.06.2021 dhe filloi në ora 14:30.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 6 antarë të komiteteve drejtori i financave si dhe zyra për informim.

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë mirë se keni ardhur në këtë dëgjim publik të kornizës afatmesme buxhetore 2022-2024. Tani mundemi me konkludu se në këtë kornizë kemi një rritje të buxhetit prej 3.75% në raport me vitin aktual pra vitin 2021 nëse e shprehim në vlerë monetare i bjen dikun 530.000euro kemi buxhet më shumë vitin e ardhshëm se sa këtë vit, ky buxhet ose kjo rritje është pasqyru në bazë të programit të aministratës së përgjithshme dhe tek programi i arsimit, programi i shëndetësisë e ka të njëjtin buxhetim sikurse vitin aktual qe jemi edhe për vitin e ardhshëm dmth nuk kemi ndonjë rritje, prandaj e kam pa shumë të arsyeshme që komitetet si komiteti për arsim, komiteti për komitete, komiteti për shëndetësi, në kuadër të kësaj kornize, në kuadër të procesit vetëhartimit buxhetit me dhanë at kontributin e tyre që ata përmes takimeve dhe aktiviteteve që kanë kry me këta sektor përkatës mi paraqit ato që ata kanë mendu që janë të domosdoshme dhe që duhet mju dhanë epilog dhe duhet me ju dha zgjidhje këtyre shqetësimeve. Komuna Malishevës total buxhetin për vitin 2022 do ta ketë 15,655,757euro nëse e krahasojmë me vitin aktual 2021 e kemi një rritje prej 3,75% apo në vlerë monetare 528,839 euro. Kjo është një rritje e buxhetit për vitin 2021 krahasuar me këtë vit ndërsa buxheti për vitin 2023-2024 këtu e kemi një rritje në raport me vitin 2022 dmth për vitin 2023 sipas qarkorës Buxhetore kjo është një projeksion nuk është definitive mundë të ndryshojë është për 1 milion më shumë, ndërsa për vitin 2024 afërsisht 2 milion më shumë është planifikuar me pas buxhet se sa vitin që jemi. Në Kuadër të kësaj rritje, rritja ka ardhur në tri programe në programin e Administratës së përgjithshme e kemi një rritje pre 6.02% ose prej 317,617 euro dhe në programin e Arsimit 211,222 euro ndërsa programi i shëndetësisë nuk është planifiku rritje nga niveli qëndror për Malishevës. Unë se kisha zgjatë më tepër veq po du me kërku edhe diqka ju që keni punu nëper komunitete jeni ballafaquar me gjitha ato kërkesat dhe nevojat që janë paraqit varësisht prej komitetit që ju përfaqësoni ne kemi përgaditë një formular për mi paraqit projektet kapitale dhe ato jo kapitale.

Valon Krasniqi: Në vitet e kaluar kam qenë prezent këtu kur kena pas dëgjime publike edhe me kryetarë të fshatrave ku secili i ka tregu projektet edhe ka pas investime projektet që kanë la këtu si prioritet kurse nfundë na asnjë nuk ju kemi mirëfill pra buxhetin e kanë ba prapë anëtarë e kuvendit. Pra ka humbur besimi në institucione shtrohet pytja pse me ardhë me kontribu ktu një kryetar i fshatit kurse ai psh krejt atë energji dhe mund duhet me dalë neper lagje dhe me pytë qytetarë ne fshat cilat janë ato projekte që kanë përparësi dhe në fund institucionet lokale nuk e mirëfillin.

Nebih Kryeziu: E diskutojmë shumë këtë qështje se unë jam anëtarë i kolegjjumit për transparencë e përfaqësoj Malishevën edhe këtu na bjen me marrë pjesë në dëgjime publike dhe na bjen shumë me diskutu pra jeta është shumë dinamike nuk është qështje besimit ose jo besimit se nuk është ky problem vetëm në Malishevë por në të gjitha komunat është i njëjtë tash qytetari don me shku në vend edhe tash jemi në këtë fazën e parë të buxhetimit dhe duhet mu kanalizu pak buxhetin jemi te qarkorja parë kurse te qarkorja dytë ka mu mbajtë nkuvend ti thirri sa dush qytatarët, kryetarë e fshatrave vijnë se ndihen ma obligativ në raport ndaj banorve të fshatrave të tyre, pra qytetari nuk vjinë asnjë ose vijnë dy ose tre nuk është tash por gjithmonë është kështu dhe jo vetëm tek ne por në të gjitha komunat është fenomen i njëjtë sepse qytetarit duhet me i shku në vend dhe me u ul rrafsh dhe me bisedu se këtu e din që nuk e mirëfillni dhe nuk është i lirë me shpreh mendimin e vet sepse ka nga të gjitha fshatrat kështu që nese i shkojmë në fshat mbushet një klasë me banorë dhe secili flet diqka në lidhje me projektet dhe investimet dhe e kemi më të lehtë hartimin e buxhetit.

Valon Mazreku: Atëher unë nuk kam diqka tjetër me shtu sa i përketë kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2022-2024 besoj dhe shpresoj që kemi me mbajtë prap takime të tjera deri atëher mirë u pafshim dhe suksese.